

VENDIM
Nr.38, datë 18.5.2006

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR
PËR REFORMËN ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.

II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor për arritjen e standardeve në zgjedhjet, mbështetur në rekomandimet e paraqitura në raportin e Komisionit Vëzhgues të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare 2005.

III. Komisioni përbëhet nga 18 anëtarë (9 nga shumica dhe 9 nga opozita parlamentare). Anëtarët që i përkasin shumicës parlamentare caktohen 3 nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, 2 nga Grupi Parlamentar “Reformator-Demokristian”, 1 nga Grupi Parlamentar i Partisë Agrare Ambientaliste dhe 1 nga Grupi Parlamentar “Qendra Demokrate”. Anëtarët që i përkasin opozitës parlamentare caktohen 3 nga Partia Socialiste, 2 nga Partia Socialdemokrate, 2 nga Lëvizja Socialiste për Integrim, 1 nga Partia Aleanca Demokratike dhe 1 nga Partia Demokracia Sociale.

IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.

V. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

VI. Vendimet në Komision merren me shumicën e votave (10 vota), kur pro tyre kanë votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha (3+3).

VII. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat prej tre muajsh nga data e vendimit.

VIII. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së Komisionit.

IX. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

- | | | |
|-----------------------|---|-------|
| 1. Ylli Pango | - | PD |
| 2. Bujar Nishani | - | PD |
| 3. Ferdinand Xhaferri | - | PD |
| 4. Arjan Madhi | - | PR |
| 5. Hajrulla Paturi | - | PR |
| 6. Nard Ndoka | - | PDR |
| 7. Ndue Shpani | - | PDK |
| 8. Petrit Gjoni | - | PAA |
| 9. Spiro Peçi | - | PBDNJ |
| 10. Ben Blushi | - | PS |
| 11. Besnik Dervishi | - | PS |
| 12. Engjëll Bejtaj | - | PSD |
| 13. Albert Divjaka | - | PSD |
| 14. Ilir Meta | - | LSI |
| 15. Sabit Brokaj | - | LSI |
| 16. Neritan Ceka | - | PAD |
| 17. Paskal Milo | - | PDS |

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)